



VENDIMI ëSHTË I PLOTFUQISHEM
ODLUKA JË PRAVNOSENZA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

Më
Dana

27. 12. 2017

P.nr.798/2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI

PENAL. gjyqtari Adem Shabani, me zyrtar ligjor Burim Haxhiderra, në çëshqjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] me vendbanim në rr. [REDACTED], Komuna-[REDACTED], i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/I.nr.169-1/17 të dt 28.03.2017, sipas së cilës e ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së duke vendosur rrëth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.12.04.2017 solli:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/I.nr.169-1/17 të dt 28.03.2017, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ema [REDACTED] me vendbanim në rr. [REDACTED], Komuna-[REDACTED], i lindur me datë, [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal [REDACTED] mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Sepse më dt. 17.01.2017 rrëth orës 18:25, në rrugën lokale "Ahmet Kaçiku", Ferizaj I pandehuri nga pakujdesia, ka shkelur ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurin, duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 61 par.1 të LSKRR-së deri sa drejtonte automjetin e tij të tipit "Suzuki", ngjyrë te zezë me targa te regjistrimit [REDACTED] në parkingun "Viva Fresh", kyçet në të majt me rrugën e lartshënuar, në drejtim të stacionit të autobusëve, duke mos pasur kujdes për pjesëmarrësit tjerë në komunikacion dhe duke mos i dhënë përparsi kalimi automjetit që lëvizte në rrugën me përparsi kalimi rrugën kryesore, nga drejtimi i stacionit të policisë, në drejtim të stacionit të autobusëve, ku me pjesë e parë të anës së majtë të automjetit godet në pjesën e pasme të anës së majt automjetin e tipit "Mercedes 124" me targa të regjistrimit [REDACTED], ngjyrë krema, të cilën e drejtonte i dëmtuari [REDACTED], në atë moment ishte duke qarkulluar në rrugën kryesore me përparsi kalimi, me çrast si pasojë e aksidentit, përvetë dëmeve materiale në automjete, lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin ka pësuar i dëmtuarit në formë përdredhje të indeve të buta të qafës.

- me të cilën kreua veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton.

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit [REDACTED], i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykit.

Nëse dënimimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjtë do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Gjykata të dëmtuarit [REDACTED], me vendbanim në rr. [REDACTED] [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale 60,88 Euro dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.169-1/17 të dt 28.03.2017 ka akuzuar [REDACTED] me vendbanim në rr. [REDACTED], Komuna-[REDACTED], për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimore kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjtë.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimore, në vështrim të nenit 495 parag.1, 2 dhe 3 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprosimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimore.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjegjësishtë konstatimin e ekspertit mjeko ligjor Dr. Musa Gashi, i dt.18.03.2017, dhe mendimin e ekspertit të komunikacionit rrugor Hajrush Leka i dt.02.03.2017 si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuarit, [REDACTED]
[REDACTED], me vendbanim në rr. [REDACTED], [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasuroror-juridike është udhëzuar në kontest civil.


Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 60,88 €uro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotefuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P.nr.798/2017 i dt.12.04.2017

Zyrtari Ligjor
Burim Haxhidema

Gjyqtari
Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtë, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimore bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënim i shqiptuar.